




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-1222/15</u>
Nr. i faq Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>24.04.2015</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.04.2015, mori:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-4927/14, për z. Ylber Asllanaj për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03 - 4927/14, për z. Ylber Asllanaj - Udhëheqës Artistik në Ansamblin "Shota", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji PKI).

Në këtë rast z. Asllanaj, është hetuar për konflikt të mundshëm interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit të Udhëheqësit Artistik në Ansamblin Shota, ushtron edhe funksionin e Redaktorit të Muzikës në Radio Televizionin e Kosovës dhe është Përgjegjës Muzikor në emisionin televiziv "Oksigjen".

Bazuar në Ligjin PKI (neni 4), z. Asllanaj, në cilësinë e Udhëheqësit Artistik të Ansamblit "Shota", nuk bënë pjesë në listën e zyrtarëve të lartë publik dhe rrjedhimisht nuk i nënshtrohet kufizimeve të këtij ligji.

Prandaj, iu kemi referuar Ligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për Ansamblet tjera si dhe Statutit, të cilët rregullojnë funksionimin e veprimtarisë kulturore dhe artistike të këtij Ansambli. Ligji dhe Statuti i Ansamblit "Shota" parasheh detyrat dhe

përgjegjësitë e udhëheqësit artistik të ansamblit mirëpo asnjëri nga këto akte normative nuk ka ndonjë dispozitë që Udhëheqësit Artistik i ndalohet ushtrimi i funksioneve tjera.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

